

PROJEKT MARREVESHJE

PER : BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“M-Fashion” shpk dhe “Lea Konfeksion” shpk

Durres me, 16.12.2024

Shoqeria “M-Fashion” shpk eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 07.06.2007 me seli Rr.Nacionale Tirane-Durres, ndertesa me nr.pasurie 35/39, ZZ 3339, Vrrin Shenavlash, Durres.

Shoqeria “M-Fashion”shpk me NIPT-in K71807501B, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 10.000.000 leke me kontribut te Ortakeve:

Taulant Koçi 1 kuote me 50% te kapitalit per 5.000.000 leke.

Rezarta Cara 1 kuote me 25% te kapitalit per 2.500.000 leke.

Ramiola Kalemi 1 kuote me 25% te kapitalit per 2.500.000 leke.

Administrator i shoqerise eshte Erald Koçi.

Shoqeria “Lea Konfeksion” shpk eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 02.11.2018, Lagjja Nr.14, Shkozet, Pasuria 6/617, Zona Kadastrale 8515, Durres.

Shoqeria “Lea Konfeksion” shpk me NIPT-in L82302505U, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 1.562.500 leke me kontribut 100% te Ortakut te vetem Shoqeria “M-Fashion”shpk.

Administrator i shoqerise eshte Taulant Koçi.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimarrrese te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” te nenit 215 pika 1.

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” hartohet ky projekt per bashkimi e shoqerive me keto kushte :

1.Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “M-Fashion” shpk do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “Lea Konfeksion” shpk do te jete shoqeria e perthithur.

2.Raporti kembimit te Kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shumën e kapitalit themeltar te sejciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit themeltar te shoqerise se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe sejcili ortak ne raport me pjesemarrjen ne kapitalit themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e sejcilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

3.Kushtet e ndarjes se kuotave te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa

pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do jete mbi bazen e rraportit qe ze sejcili kapital themeltar i shoqerive te vecanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.

4.Data, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqerise se re pas perthithjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit do te jete 01.01.2024.

5.Data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë "Lea Konfeksion" shpk që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse "M-Fashion" shpk do te jete 01.01.2024.

6.Të drejtat që shoqëria përthithëse "M-Fashion" shpk u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise perthithese "M-Fashion" shpk. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

7.Perparesite apo kufizimet e Administratorit te shoqerise se re pas perthithjes do te jene ato qe i njeh statuti i shoqerise perthithese "M-Fashion" shpk. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

8.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te punesuarve te te dyja shoqerive qe marrin pjese ne procesin e perthithjes.

9.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te treteve te sejciles shoqeri para perthithjes.

10.Ortake te shoqerise se re do jene: Taulant Koçi, Rezarta Cara dhe Ramiola Kalemi

11.Emri i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete "M-Fashion" shpk

12.Selia e shoqerise se re do jete ajo e shoqerise "M-Fashion" shpk para perthithjes; Rr.Nacionale Tirane-Durres, ndertesa me nr.pasurie 35/39, ZZ 3339, Vrrin Shenavlash, Durres.

13.Statuti i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "M-Fashion" shpk para perthithjes

14.Objekti veprimtarise i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "M-Fashion" shpk para perthithjes

15.Administrator i shoqerise se krijuar nga bashkimi do jete Erald Koçi me nje mandat 5 vjeçar.

16.Baza e nisjes per bashkimin do te jene treguesit e bilancit te dates 31.12.2023, ndersa aktiviteti i vitit 2024 do te jete i perbashket me sistemimet e nevojeshme sipas Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne zbatim te ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

17.Kapitali aksioner dhe Perqindjet (te trajtuara ne piken 2 dhe 3 si me siper) e sejcilit ortak ne kapitalin e ri themeltar te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqitjes se aktit te ekspertimit nga shoqeria Audituese "Gosnishti Auditors And Partners" shpk me Nipti-in L32423013P e rregjistruar ne rregjistrin publik te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) me Nr. 398 date 31.03.2004.

18. Fitimi nga kapital i tatushem ne zbatim te ligjit 29/2023 date 30.03.2023 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", Neni 46, pika 2 ku theksohet "Një riorganizim biznesi nuk shkakton tatim të fitimeve kapitale mbi aktivet e transferuara për t'i dhënë efekt riorganizimit, përveç ndonjë pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla", dhe Udhezimit te pergjitheshem 26 date 08.09.2023 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", pika 46.1 ku theksohet "Fitimi kapital nuk tatohet në momentin e riorganizimeve të biznesit të tilla si bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, shkëmbimi i aksioneve dhe transferimet e degëve të veprimtarisë. Kjo lejon zhvillim dhe rritje pa probleme të ndërmarrjeve, bashkimi me perthithje behet mbi bazen e bashkimit te kapitaleve te te dyja shoqerive dhe nuk ka pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla.

19. Te drejtat dhe detyrimet e shoqërisë "Lea Konfeksion" shpk do t'i kalojnë shoqërisë "M-Fashion" shpk.

20. Shoqëria perthithet "M-Fashion" shpk dhe shoqëria e perthithur "Lea Konfeksion" shpk me miratimin e Ortakëve me të drejtë vote, të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, në zbatim të pikës 7 të nenit 216 të ligjit 9901 datë 14.4.2008 për "Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare", përjashtojnë detyrimin për pasqyrat kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, po të nenit 216 të ligjit 9901 datë 14.4.2008 për "Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare"

Per Shoqërinë "M-Fashion" shpk

Perfaqësuesi Ligjor

Erald Koçi



Per Shoqërinë "Lea Konfeksion" shpk

Perfaqësuesi Ligjor

Taulant Koçi

